



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 127, datë 21.06.2019

PËR

**MIRATIMIN E QËNDRIMIT NË DETYRË TË ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË
SË SIGURIMIT “EUROSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 25, pika 3, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Shoqëria e sigurimit “Eurosig” sh.a. ka depozituar me shkresën nr. 4345 prot., datë 05.06.2019, vendimin e Asamblesë së Aksionarëve nr. 6, datë 05.06.2019, nëpërmjet të cilit kërkon riemërimin e z. Xhevdet Kopani si Administrator i shoqërisë “Eurosig” sh.a. deri në përzgjedhjen e kandidaturës së përshtatshme.

Kjo kërkesë është ridepozituar dhe me shkresën e shoqërisë nr. 4722 prot., datë 17.06.2019.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

V E N D O S I:

1. Miratimin e qëndrimit në detyrë të z. Xhevdet Kopani, si Administrator i shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., për një periudhë, deri në 30.09.2019.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI